



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:287099

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05739830

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr..../...

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Mus Povataj, me pjesëmarrjen të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurve M..... L..... shkak të veprave penale shmangia nga tatimit nga neni 307 par. 1 lidhur me nenin 77 i KPRK-së dhe ndihma në kryerjen e veprës penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256 par. 1 lidhur me nenin 33 dhe 77 i KPRK-së dhe L.... L....për shkak të veprës penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256 par. 1 lidhur me nenin 77 i KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II.nr. 2576/21 të datës 31.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 02.05.2024 të hapur për publikun, në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të pandehurve M..... L..... dhe mbrojtësi i të tij av. F..... K..... sipas autorizimit, të pandehurit L..... L..... dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës ATK-së P..... A.... K.... sipas autorizimi, me datë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit,

M..... L....., i lindur me datën në fsh. Sh... K. D..., me banim në D... rr. "M... T..." nr., i biri i A.... dhe nënës N.... e vajzërisë S..., posedues i nr. tel., i identifikuar në bazë të numrit personal, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa dënuar me par, mbrohet në liri.

L.... L....., i lindur me datën në fsh. Sh.... K. D..., ku banon ne D... rr. S... Q..., i biri i Q.... dhe nënës A.... e vajzërisë D....., posedues i nr. tel., i identifikuar në bazë të numrit personal, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa dënuar me parëm, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Për shkak se: i pandehuri M..... L.....:

I. Nga data e në vazhdimësi gjer me datën në J..., me qëllim që t'i shmanget tërësisht pagesës së tatimit që kërkohen me ligj dhe atë sipas nenit 43 par. 2 nën par. 2.1 të Ligjit për tatim në të ardhurat personale, nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, në atë mënyrë që, i

pandehuri në biznesin e tij “T... D...” me rastin e ushtrimit të veprimtarisë së dentistit, prej datës 25.02.2019 e gjer me datën 24.09.2019 nuk i deklaroi fare të ardhurat e tij në shumën prej 73,584.31€, për çka i shmanget tatimit në vlerë prej 7,817.09 € kur edhe hetohet nga zyrtarët e DHKEK.

- me çka ka kryer veprë penale shpangia nga tatimit nga neni 307 par. 1 lidhur me nenin 77 i KPRK-së.

II. Në kohë të panjohur e në vazhdimësi gjer me datën 24.09.2019 në J...., me dashje ndihmon personin tjetër në kryerjen e veprës penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256 par. 1 të KPRK-së dhe atë të pandehurit L... L....., në atë mënyrë që, i pandehuri Muhamet, i ndihmon të pandehurit L..., që pa pasur kualifikime profesionale, në ordinancën e tij “T... D...” të ushtroj profesionin e mjekut stomatolog.

- me çka ka kryer veprë penale ndihma në kryerjen e veprës penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256 par. 1 lidhur me nenin 33 dhe 77 i KPRK-së.

Për shkak se: i pandehuri L... L.....:

III. Në kohë të panjohur e në vazhdimësi gjerë me datën, në J..., pa pasur kualifikime profesionale, kryen trajtime mjekësore, në atë mënyrë që, i pandehuri në ordinancën “T... D...”, pa e kryer fakultetin e mjekësisë ushtron profesionin e mjekut stomatolog duke kryer intervenime tekë klient të ndryshëm deri me datën kur hetohet nga hetuesit e DH.....

- me çka ka kryer veprë penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256 par. 1 lidhur me nenin 77 i KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 7, 17, 38, 39, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72, 185 të KPRK-së dhe nenit 364, të KPPRK- së, të akuzuarit i gjykon ashtu që:

Të pandehurit M..... L..... i përcakton;

Për veprën penale nga pika I e dispozitiv të këtij aktgjykimi: **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit komfor nenit 44 të KPRK-së, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 1.000 (njëmijë) euro dhe **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 1.000,00 € (njëmijë) euro.

Për veprën penale nga pika II e dispozitiv të këtij aktgjykimi, **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 800,00 € (tetëqind) euro.

Konform nenit 76 të KPRK-së të pandehurit i M..... L..... i shqiptohet **DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumë prej **2.800,00 €** (dymijë e tetëqind euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj brenda 5 (pesë muajve) , pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Të pandehurit L... L.... i përcakton;

DËNIM ME GJOBË në shumë prej **1.800,00 € (njëmijë e tetëqind euro)**, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj brenda 4 (katër muajve), pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse të pandehurit nuk e paguajnë dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të ju shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

Të pandehuri secili veç e veç obligohen që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 80,00 € (tetëdhjetë euro) në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

E dëmtuara A... në P.... e përfaqësuar nga A.... K.... sipas autorizimit, për realizimin e kërkesës juridike udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm ka ngrit aktakuzë PP/II.nr. 2576/21 të datës 31.12.2021, ndaj të pandehurve ndaj të pandehurve M..... L..... shkak të veprave penale shmangia nga tatimit nga neni 307 par. 1 lidhur me nenin 77 i KPRK-së dhe ndihma në kryerjen e veprës penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256 par. 1 lidhur me nenin 33 dhe 77 i KPRK-së dhe L.... L....për shkak të veprës penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256 par. 1 lidhur me nenin 77 i KPRK-së.

Në shqyrtimin kryesor të datë gjykata i ka udhëzuar të pandehurit për të drejtat e tyre për të mos u deklaruar në çështjen e tyre ose të mos përgjigjen në pyetje dhe nëse ata deklarohen për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij.

Pasi të pandehurit kanë hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës, gjykata është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën. Më pas gjykata i ka njoftuar te pandehurit për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë dhe i ka njoftuar se me Kodin Penal të Kosovës, pranimi i fajësisë është paraparë si njëra prej rrethanave lehtësuese me rastin e caktimit dhe lartësisë së dënimit. Ky është favorimi mirëpo me pranimin e fajësisë nuk do të ketë procedurë të provave ku ju do te keni mundësi ti kundërshtoni provat e aktakuzës dhe njëkohësisht të merrni prova në mbrojtjen e juaj. Përfundimisht aktgjykimi në bazë të pranimit të fajësisë nuk mund të ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

I pandehuri M..... L..... ka deklaruar se e pranoi fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohem nga pika I dhe II e kauzës, sa i përket pikës I e kam përmbushur obligimin ndaj të dëmtuarës, kërkoj falje ,me vjen keq.

I pandehuri L.... L....ka deklaruar se e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, tani e kam të përfunduar fakultetin e mjekësisë drejtimin infermieri e përgjithshme, ne vitin 2023, me vjen keq, kërkoj falje dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris ndonjë herë tjetër.

Ne vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve M.... L.... dhe L... L..... Ne drejtim të veprave penale me të cilat ngarkohen si në aktakuza, pasi pranimi i fajësisë u bë në mënyrë vullnetare nga të njëjtit e po ashtu gjen mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërsa përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës A.... K.... ka deklaruar; pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit M..... L..... , sa i përket kërkesës pasurore juridike bazuar në pasqyrën tatim-paguesit të datës 18.11.2021 si dhe në raportin informues nga drejtoria rajonale e A...-së në P... dhe po ashtu nga informatat tjera nga zyra e tanishme të akuzuarit ka kryer obligimet tatimore dhe në gjendjen e tij nuk figuron borxhe të pashlyera.

Mbrojtësi i të pandehurit M..... L..... av. F.... K.... ka deklaruar: kërkoj nga gjykata që pranimin e fajësisë në shqiptimin e dënimit ta marr si rrethanë posaçërisht lehtësuese duke e ditur se i njëjti pranim është bërë pa presion me vullnet të plot duke i ditur benefitet dhe pasojat për pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPRK-se dhe 322 të KPPRK-së, ngase aktakuza mbështet në këto prova: Raporti informues i Policisë së Kosovës dt. 24.11.2020; Raporti i ATK-së dt. 15.11.2021; Pasqyra e tatimpaguesit dt. 18.11.2021; Libri i shitjes; Fletorja e të pandehurit M..... L.....; Shënimi zyrtar i Policisë së Kosovës dt. 19.05.2021; Raporti i oficerit S..... G..... K.I. 1005 dt. 24.09.2019; Raporti i shpejtë dt. 24.09.2019; Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve dt. 24.09.2019; Shënimi zyrtar i Policisë së Kosovës dt. 07.10.2019; Fotografitë e vendit të ngjarjes; Email i dt. 12.05.2021; Raport inspektimi SPSH "M..... L....." dt. 07.10.2019 ref.10/NY-23-19; Procesverbali mbi inspektimin e bërë me nr. 003953 dt. 04.10.2019; Vendimi me nr. 10/NY-25-19 dt. 07.10.2019; Fatura nr. 0001199; dhe Fletëpagesa dt. 08.10.2019 andaj ka marr aktvendim me të cilin gjykata ja ka pranuar fajësinë të pandehurve duke vazhduar me dhënien e fjalës përfundimtare.

Në fjalën përfundimtare Prokurorja e Shtetit Ardiana Veseli ka deklaruar: qëndroj pran aktakuzës dhe gjendjes faktike të përshkruar si në diapozitivin e I, II , dhe të III, i propozoj gjykatës që ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit dhe të obligoj në pagesën e Shpenzimeve procedural, po ashtu propozoj gjykatës që pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes dhe shqiptimin e dënimit ndaj të njëjtëve , ndërsa si rrethanë rënduese të marr parasysh dashjen e të pandehurve në kryerjen e këtyre veprave penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës A.... K.... në fjalën përfundimtare ka deklaruar: pajtohem në tersi me fjalën e prokurores së shtetit dhe qëndrojmë pran deklaramëve të më hershme.

Mbrojtësi i të pandehurit M..... L..... av. F..... K..... në fjalën përfundimtare ka deklaruar: i propozoj gjykatës që si rrethanë posaçërisht lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga ana e këtu të pandehurit , pendimi i tij i thellë për veprat e kryera , premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale e po ashtu esenciale për këtë procedurë të merret që i njëjti e ka kryer në tërësi demin e shkaktuar palës së dëmtuar , po ashtu si rrethanë lehtësuese i propozoj gjykatës që te mret e kaluara e tij i cili është hera ep ar qe ka ra ndesh me ligjin , dhe duke i pas parasysh te gjitha këto rrethana te cekuar kërkoj nga ana e gjykatës që të mbrojturit tim ti shqiptoji një dënim minimal i cili parashihet në bazë të dispozitave ligjore.

I akuzuari M..... L..... në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se pajtohem me fjalën e mbrojtësit tim plotësisht.

I akuzuari L.... L....në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se i propozoj gjykatës që të më shqiptoj ndonjë dënimin minimal sepse në të ardhëm nuk do te përsëris veprime te tilla.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve Muhamet dhe L.... L.... i cili mbështet në provat në bazë të së cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Muhamet Lushaj qëndrojnë të gjitha elementet e veprave penale shmangia nga tatimit nga neni 307 par. 1 lidhur me nenin 77 i KPRK-së dhe ndihma në kryerjen e veprës penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256 par. 1 lidhur me nenin 33 dhe 77 i KPRK-së ndërsa ne veprimet e të pandehurit L.... L....qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256 par. 1 lidhur me nenin 77 i KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurve dhe të njëjti janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 74 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin M..... L....., gjykata mori pranimin e fajësisë në shqyrtim kryesorë, keq ardhjen e shfaqur, faktin se me parë nuk ka qenë të dënuar, faktin se i njëjti për veprën penal nga pika një e dispozitiv të këtij aktgjykimi e ka kompensuar dënimin e shkaktuar ndaj ATK-së ne shumë prej 7,817.09 euro, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprave penale nga pika I dhe II e dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa si rrethana lehtësuese për të pandehurin L.... L....., gjykata mori pranimin e fajësisë në shqyrtim kryesorë, keq ardhjen e shfaqur, faktin se me parë nuk ka qenë të dënuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurve gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes ne kryerjen e veprës penale

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si në dispozitat të këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK i cili konsiston në

parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, i obligoi të akuzuarit secili veç e veç që ti paguaj shpenzimet për paushall gjyqësor në shumë prej 60,00 €, e duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj dhe 20,00 € për taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata ka vlerësuar propozimin e Prokurorit të Shtetit për shqiptimin e dënimit plotësues në kuptim të nenit 64 urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit mirëpo i pandehuri M..... L..... me anë të parashtrës së datës 26.05.2023 i ka dëshmuar gjykatës kompensimin e dënimit ndaj ATK-së e cilin fakt e ka konfirmuar në shqyrtim kryesor edhe përfaqësuesi i autorizuari i ATK-së, andaj gjykata ka gjetur se Propozimi i Prokurorit në këtë fazë të procedurës nuk është i bazuar.

Komfor nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2021:287099, 27.05.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

G j y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë ditëve) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.